

RREGULLORE
PËR NGRITJEN DHE FUNKSIONIMIN E
KËSHILLIT TË PROFESORËVE
TË FAKULTETEVE TË UNIVERSITETIT POLITEKNIK TË TIRANËS

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Këshilli i Profesorëve, (më tej, KP), ngrihet në zbatim të Ligjit Nr. 9741 datë 21.05.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 19; VKM Nr. 467, datë 18.07.2007 “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave për kualifikimin, shkencor e pedagogjik, të personelit akademik”, pika 1.5 dhe Statutit të Universitetit Politeknik të Tiranës, neni 25.

Neni 2

Në përputhje me VKM Nr. 467, dt. 18.07.2007, pika 1.5, në KP bëjnë pjesë të gjithë profesorët, me kohë të plotë, të fakultetit. Numri minimal i profesorëve të KP-së duhet të jetë shtatë veta. Në rast se numri i profesorëve të fakultetit është më i vogël se shtatë, për të arritur këtë numër në KP mund të thirren profesorë të fushave të afërta, nga Institutet e Kërkimit e Zhvillimit dhe Fakultetet e tjera, brenda universitetit, profesorë të ftuar apo profesorë me kontratë të fakultetit ose anëtarë, me titullin “Prof.Asoc.”, që janë në procesin e aplikimit për titullin “Profesor”.

Neni 3

Kur numri i profesorëve të fakultetit është më i vogël se shtatë, dekani i fakultetit, në konsultim me profesorët me kohë të plotë të fakultetit, i propozon për miratim rektorit të UPT emrat e anëtarëve të tjerë që do të jenë në përbërje të Këshillit të Profesorëve të këtij fakulteti.

Neni 4.

Këshilli i Profesorëve të Fakultetit ngrihet në mbledhjen e profesorëve të fakultetit përkatës, ku marrin pjesë të gjithë profesorët.

Neni 5

Sipas VKM Nr. 467 dt 18.07.2007, pika 1.5, paragrafi 2, Drejtuesi i KP, ka mandat për një vit akademik, dhe zgjidhet me rotacion.

Neni 6

Të gjitha njësitë kryesore të UPT, në mbështetje të VKM Nr. 467 datë 18.07.2007, pikat 1.3 dhe 1.4, kanë të drejtë të promovojnë personelin akademik për titujt "Docent", "Profesor i Asociuar", "Profesor" dhe "Profesor emeritus".

Neni 7

Profesorët e një fakulteti që thirren në KP e një fakulteti tjetër, mbeten njëkohësisht edhe anëtarë të KP së fakultetit ku bëjnë pjesë me kohë të plotë.

Neni 8

Këshilli i Profesorëve mblidhet kur janë të pranishëm jo më pak se pesë të shtatat e antarëve të tij. Vendimet merren me shumicë të thjeshtë. Votimet në KP bëhen të fshehta. Në mbledhjet e KP ku do të votohen titujt "Docent" dhe "Profesor i Asociuar", duhet të jenë të panishëm:

- Për KP me shtatë anëtarë, të gjithë anëtarët e tij.
- Për KP me më shumë se shtatë anëtarë, pesë të shtatat e antarëve të tij.

KREU II

GRADA SHKENCORE "DOKTOR"

Neni 9

Procedurat për dhënien e Gradës shkencore "DOKTOR" (Për kandidatët e regjistruar para 31.12.2007)

Studentët, që janë regjistruar në studimet e doktoratës:

- a. Përpara datës 31 dhjetor 2005, kanë plotësuar kërkesat e vendimit nr.786, datë 17.12.1998, të Këshillit të Ministrave, "Për kualifikimin shkencor, pasuniversitar dhe për klasifikimin e punonjësve pedagogjikë e kërkimorë", të ndryshuar, dhe dorëzojnë në dekanat dosjen e plotë me disertacionin e përfunduar deri më 31 dhjetor 2008, kryejnë mbrojtjen e doktoratës, sipas procedurave të parashikuara në shkronjën "c", të pikës 5, të vendimit nr.864, datë 5.12.2007, të Këshillit të Ministrave.
- b. Nga data 1 janar 2006 deri më 31 dhjetor 2007 dhe studentët e përcaktuar në shkronjën "a", të ketij neni, por që nuk arrijnë të dorëzojnë dosjen brenda afatit të përcaktuar më sipër, do t'i vazhdojnë studimet në ciklin e rregullt, sipas vendimit nr.786, datë 17.12.1998, të Këshillit të Ministrave, "Për kualifikimin shkencor pasuniversitar dhe për klasifikimin e punonjësve, pedagogjikë e kërkimorë", të ndryshuar, por do të plotësojnë kriteret e pikës 5, të vendimit nr.864, datë 5.12.2007, të Këshillit të Ministrave, për mbrojtjen e doktoratës.

- c. Pas datës 1 janar 2008 e në vazhdim, i përfundojnë ato në përputhje me ligjin nr.9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe me vendimin nr.864, datë 5.12.2007, të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 10

Procedurat për ngritjen dhe funksionimin e Jurisë së Mbrojtjes së Doktoratave

- a. Juria e mbrojtjes propozohet nga Këshilli i Profesorëve të fakultetit ku dorëzohet kërkesa për mbrojtje dhe miratohet nga Rektori i Universitetit.
- b. Juria e mbrojtjes përbëhet prej 5 vetësh, 1 kryetar dhe 4 anëtarë, prej të cilëve të paktën 3 me tituj shkencorë dhe 2 me gradë shkencore. Tre prej anëtarëve të Jurisë duhet të jenë të jashtëm për institucionin ku është përgatitur disertacioni.
- c. Juria cakton dy oponentë nga radhët e saj.
- d. KP, propozimin e vet për përbërjen e jurisë ja komunikon paraprakisht disertantit, i cili ka të drejtë të bëjë vërejtje për ndryshimin e saj dhe, në rast mosmirëkuptimi, mund t’i drejtohet Rektorit të Universitetit, që jep vendimin përfundimtar.
- e. Mbrojtja e disertacionit bëhet me pjesëmarrjen e plotë të jurisë. Kur mungon ndonjë pjesëtar i jurisë, mbrojtja shtyhet për një datë tjetër.
- f. Procedura e mbrojtjes së doktoratës përfshin:
 - Leximin nga kryetari i jurisë i lejes së mbrojtjes dhe i përbërjes së jurisë, të miratuar nga Rektori i Universitetit.
 - Paraqitje e përmbledhjes së disertacionit nga disertanti për një kohë prej 25-30 minuta.
 - Paraqitje e oponencave.
 - Pyetje nga të pranishmit rreth disertacionit dhe oponencave drejtuar autorëve të tyre dhe përgjigjet për to.
 - Diskutime
 - Sqarime e replika eventuale nga disertanti dhe udhëheqësi shkencor.
 - Shpërndarje e fletë-votimeve të hapura e të paplotësuara dhe votim i fshehtë për vlerësimin e disertantit.
 - Fiksim në procesverbal i rezultatit të votimit dhe shpallje e vendimit me shkrim.
- g. Vlerësimi bëhet deri me 10 pikë nga secili anëtar i jurisë dhe ka këto shkallë: 50-43 pikë = “shumë mirë”, 42-35 pikë = “mirë”, 34-26 pikë = “mjaftueshëm”, nën 26 pikë = “rrezohet”.
- h. Disertantit i dorëzohet diploma përkatëse pasi ka plotësuar të gjitha detyrimet, përfshirë edhe depozitimin e kopjeve të disertacionit në Bibliotekën Kombëtare dhe në Bibliotekën Shkencore të Universitetit.
- i. Disertacioni i rrëzuar mund të ripunohet dhe të paraqitet për mbrojtje për herë të dytë, pas një periudhë prej 1 deri 2 vjetësh, pas së cilës humbet e drejta për rimbrotjen e tij.

Neni 11

KP, pasi merr kërkesën e kandidatit dhe dosjen e plotë të tij ku përfshihet disertacioni i përgatitur, një përmbledhje e miratuar nga udhëheqësi shkencor, mendimi i udhëheqësit shkencor, mendimi i Departamentit përkatës:

- E regjistron atë në librin e protokolleve të KP.
- Kontrollon dosjen nëse është në përputhje me kërkesat e parashikuara në VKM Nr.786, datë 17.12.1998, VKM Nr.864 datë 05.12.2007, të ndryshuar me VKM Nr. 877, datë 18.06.2008.
- KP, pasi shqyrton dosjen, merr vendim për vazhdimin ose jo të procedurës së mbrojtjes së doktoratës. Në rastin e pranimit të kërkesës, vendimi i KP si dhe propozimi për përbërjen e jurisë së mbrojtjes, i përcillen dekanit të fakultetit, i cili kontrollon zbatimin e procedurës dhe ja përcjell për miratim përfundimtar rektorit të UPT.
- KP-ja merr vendim brenda 1 muajve nga paraqitja e kërkesës.
- Pas miratimit të kërkesës së mbrojtjes dhe përbërjes së jurisë nga rektori i universitetit, mbrojtja mund të organizohet jo më parë se një muaj nga data e miratimit. Procedurat e mëtejshme i ndjek juria e miratuar.
- Në rastin e mos miratimit të kërkesës, kandidatit i jepet përgjigje me shkrim, me firmën e Drejtuesit të KP. Kandidati ka të drejtë të riparaqesë kërkesën për të filluar procedurën e mbrojtjes jo më parë se gjashtë muaj, pas refuzimit të kërkesës së parë.
- Diploma “Doktor”, pasi nënshkruhet nga dekani dhe rektori, regjistrohet në regjistrin e gradave të Universitetit.

KREU III

TITUJT AKADEMIKË

Neni 12

Procedurat për dhënien e titullit “DOCENT”

KP, pasi merr kërkesën e kandidatit:

- E regjistron atë në librin e protokolleve të KP.
- KP shqyrton dosjen dhe merr vendim për pranimin ose jo të kërkesës. KP, për rastin pozitiv, vendos shpalljen e datës së paraqitjes së leksionit të hapur të kandidatit/es.
- Vendimi për dhënien e titullit merret në një mbledhje të veçantë të KP, brenda tre muajsh nga data e dorëzimit të kërkesës.
- Kur vendimi i KP është pozitiv, ajo i dërgon dekanit propozimin për dhënien kandidatit të titullit “Docent”.
- Diploma “Docent”, pasi nënshkruhet nga dekani dhe rektori, vuloset me vulë të thatë dhe regjistrohet në regjistrin e Universitetit dhe në Ministri.
- Në rastin e mos miratimit kandidati ka të drejtë të riparaqesë kërkesën për të fituar

titullin "Docent", jo më parë se 2 vjet, pas refuzimit të kërkesës së parë.

- Në të dy rastet, vendimi regjistrohet në librin e protokolleve të KP.

Neni 13

Kriteret për marrjen e titullit "DOCENT"

Kriteret e veçanta që duhet të plotësojnë kandidatët për marrjen e titullit "Docent":

- Pas marrjes së gradës shkencore "Doktor" të kenë jo më pak se një vit përvojë mësimdhënie në institucionet e arsimit të lartë,
- Pas marrjes së gradës shkencore "Master i Nivelit të Dytë", ose ekuivalente me të, të vlerësuar me rezultatin "shumë mirë" ose "shkëlqyer", të kenë, së paku, 5 vjet përvojë në mësimdhënie, në institucionet e arsimit të lartë.
- Për një lëndë ose modul, të kenë përgatitur materiale mësimore (skripte, leksione, udhëzuesa praktikash ose ushtrimesh).
- Të kenë realizuar, së paku, tri referime të shkurtra ose paraqitje (postera) në konferenca e kongrese shkencore, nga të cilat, së paku, një referim ose paraqitje duhet të jetë mbajtur në një veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres), ku punimet janë pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe janë botuar në "Proceedings";
- Të kenë botuar, së paku, dy artikuj shkencorë origjinalë ose review (analiza shkencore) në revista shkencore, nga të cilët, së paku, njëri duhet të jetë botuar ose pranuar për botim në një revistë shkencore të huaj, të njohur, me bord editorial.

Neni 14

Procedurat për dhënien e titullit "Profesor i Asociuar"

Profesori i Asociuar është anëtar i personelit akademik, titullar i lëndëve ose moduleve dhe udhëheqës i veprimtarisë së kërkimit shkencor që ka gradën "Doktor".

Pas dorëzimit të kërkesës nga kandidati për titull:

- a. KP, brenda një muaji, vendos për ngritjen e një Komisioni Vlerësues (më tej KV) me 7 antarë., që kanë titullin profesor, nga të cilët dy të shkencave teorike bazë. Katër antarë të KV zgjidhen nga jashtë KP së Fakultetit. Në përbërje të KV-së mund të jetë edhe një profesor i fushës ose i një fushe të afërt, nga universitetet e huaja. Në këtë rast kandidatit/es i kërkohet që dosjen dhe referatin e hapur, t'i paraqesë edhe në një gjuhë të huaj, që ai/a jo zotëron dhe që është e përshtatshme për anëtarët e KV-së.
- b. KV, brenda tre muajsh nga data e dorëzimit të dosjes, merr pjesë në tri seanca mësimore dhe e fton kandidatin/en në një referat të hapur shkencor;
- c. KV harton një raport përfundimtar vlerësues për veprimtarinë botuese dhe aftësitë pedagogjike të kandidatit/es, të cilin ia paraqet KP-së, së bashku me rekomandimin për dhënien ose jo të titullit;

- d. KP, në një mbledhje të veçantë, shqyrton raportin përfundimtar vlerësues të KV dhe merr vendim për dhënien ose jo të titullit.
- e. Në rastin e vendimit pozitiv, Drejtuesi i KP, njofton me shkrim Dekanin e Fakultetit.
- f. Diploma "Prof.Asoc." nënshkruhet nga dekani e rektori, vuloset me vulë të thatë dhe regjistrohet në regjistrin e universitetit dhe në ministri.
- g. Kur vendimi i KP është negativ, kandidati i jepen argumentet përkatëse. Kandidati ka të drejtë të rifillojë procedurën jo më parë se dy vjet nga data e refuzimit të kërkesës së parë;

Neni 15

Kriteret për marrjen e titullit "Profesor i Asociuar"

Titulli "Profesor i Asociuar" (Prof. Asoc.) u jepet anëtarëve të personelit akademik, të cilët kanë fituar gradën shkencore "Doktor" dhe përmbushin kriteret e mëposhtme:

- a. Të kenë, së paku, tre vjet përvojë në mësimdhënie (së paku, pesë vjet për lektorët e ftuar) dhe gëzojnë aftësi të mirë mësimdhënëse. Titulli "Docent" nuk është parakusht për kërkimin e titullit "Prof.Asoc.";
- b. Të kenë realizuar, pas doktoratës, së paku, 8 referime të shkurtra ose paraqitje (postera) në konferenca dhe kongrese shkencore, nga të cilat, së paku, pesë duhet të jenë mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres), ku punimet janë pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe janë botuar në "Proceedings";
- c. Të kenë botuar, pas doktoratës, së paku, 5 artikuj shkencorë origjinalë ose review (analiza shkencore) në revista shkencore, nga të cilat, së paku, në 2 prej tyre si autor i parë, si dhe, së paku, 2 prej tyre të jenë botuar ose pranuar për botim në një revistë shkencore të huaj, të njohur, me bord editorial. Së paku, një artikull, duhet të jetë botuar në një revistë shkencore të huaj, me faktor impakti;
- d. Të kenë qenë titullarë, së paku, të një lënde a moduli për më shumë se dy vite akademike dhe të kenë përgatitur materiale mësimore, në formë skriptesh, cikël leksionesh, udhëzues praktikash ose ushtrimesh.
 - Një monografi shkencore, e botuar si autor i parë, në gjuhë të huaj, që mban numër ISBN-je, vlerësohet e barabartë me deri 6 artikuj shkencorë.
 - Një monografi shkencore, e botuar si autor i parë, në gjuhën shqipe që mban numër ISBN-je, vlerësohet e barabartë me deri 4 artikuj shkencorë, të botuar brenda vendit.

Neni 16

Procedurat për dhënien e titullit "Profesor"

Pas kërkesës dhe dorëzimit të dosjes nga kandidati:

- Brenda një muaji, KP-ja verifikon dosjen dhe merr vendim për t'ja përcjell atë senatit të UPT, së bashku propozimin për përbërjen e komisionit vlerësues (KV).
- Komisioni vlerësues përbëhet nga 7 anëtarë, të cilët duhet të kenë titullin "Prof.". Së paku, pesë anëtarë të KV-së duhet të jenë jashtë universitetit, nga vjen kandidati/ja dhe, së paku, dy anëtarë të KV-së duhet të jenë profesorë të shkencave teorike bazë. Në përbërje të KV-së mund të jetë edhe një profesor i fushës ose i një fushe të afërt, nga universitetet e huaja. Në këtë rast kandidatit/es i kërkohet, që dosjen dhe referatin e hapur ta paraqesë edhe në një gjuhë të huaj, që ai zotëron dhe që është e përshtatshme për anëtarët e KV-së;

Neni 17

Kriteret për marrjen e titullit "Profesor"

Titulli "Profesor" (Prof.) u jepet anëtarëve të personelit akademik, që kanë fituar gradën shkencore "Doktor" dhe përmbushin kriteret e mëposhtme:

- a. Kanë së paku, pesë vjet përvojë në mësimdhënie (së paku shtatë vjet për lektorët me kohë të pjesshme), pas marrjes së gradës shkencore "Doktor".
Titujt "Docent" dhe "Prof.Asoc." nuk janë parakusht për kërkimin e titullit "Profesor";
 - b. Kanë pasur një përvojë kërkimore ose mësimdhënëse prej, së paku, një viti, në një institucion kërkimor-mësimor, jashtë vendit. Përvoja të tilla vlerësohen, kur qëndrimet në institucionet homologe jashtë shtetit kanë qenë pa ndërprerje ose edhe me ndërprerje;
 - c. Janë në gjendje të mbajnë, në nivel të kënaqshëm, leksione të veçanta ose cikle leksionesh, në njërin nga këto gjuhë të huaja: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht dhe rusisht;
 - d. Kanë realizuar si autorë të parë, pas marrjes së gradës "Doktor", së paku, 15 referime të shkurtra ose paraqitje (postera) në konferenca dhe kongrese shkencore, nga të cilat, së paku, 8 duhet të jenë mbajtur ose paraqitur në një veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres) ku punimet janë pranuar, në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe janë botuar në "Proceedings";
 - e. Kanë botuar, pas marrjes së gradës "Doktor", së paku, 9 artikuj shkencorë origjinalë ose review (analiza shkencore) në revista shkencore, nga të cilët 4 si autorë të parë, si dhe, së paku, 4 prej tyre duhet të jenë botuar ose pranuar për botim në një revistë shkencore të huaj, të njohur me bord editorial. Së paku, dy artikuj duhet të jenë botuar në një revistë shkencore të huaj, me faktor impakti;
 - f. Kanë qenë titullar, së paku, të një lënde a moduli për më shumë se katër vite akademike dhe kanë përgatitur materiale mësimore, në formë skriptesh, leksionesh, udhëzues praktikash ose ushtrimesh për programin mësimor të dy ose më shumë lëndëve a moduleve, njëra prej të cilave në ciklin e dytë të studimeve "Master".
- ☞ Një monografi shkencore e botuar, si autor i parë, në gjuhë të huaj, që mban numër

ISBN-je, vlerësohet e barabartë me deri gjashtë artikuj shkencorë.

- ☞ Një monografi shkencore, e botuar, si autor i parë, në gjuhën shqipe, që mban numër ISBN-je, vlerësohet e barabartë me deri katër artikuj shkencorë, të botuar brenda vendit.

KREU IV
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 18

Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit në Senatin e Universitetit Politeknik dhe është e detyrueshme për zbatim nga të gjithë Këshillat e Profesorëve të fakulteteve të tij.

Miratuar me Vendimin e Senatit të UPT, Nr. 9, datë 01.10.2008.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Jorgaq KAÇANI